

AKT NORMATIV
Nr.5, datë 30.11.2019

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI
TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në fund të pikës 1, të nenit 21, “Shpenzime të panjohura”, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar, shtohet shkronja “p”, me këtë përmbajtje:

“p) Donacionet në mjete monetare mbi nivelin 5% të fitimit para tatimit, të bëra për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” brenda afatit të përcaktuar, dhe të transferuara në llogaritë e thesarit. Në rastet kur donacionet për shkak të shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” janë në formën e pasurive të paluajtshme, vlerësimi i kontributit deri në nivelin 5%, në raport me fitimin para tatimit llogaritet sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama